

01-2219



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-276527/22 dt. 28.12.2022, të kërkuarit/ pronarëve Muharrem Sinani, Ekrem Biqku, Fatos Ferizaj, Shefqet Behramaj, Zijadin Biqkaj, Besnik Krasniqi, Afrim Mehmeti, Vigan Biqkaj, Labinot Biqkaj, Ardita Brajshori Biqkaj dhe Faton Biqkaj, me investitor “Art Construction LLC” me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Faton Sinani nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm dhe ndërtesës administrative, përkatësisht “Art Construction 7 – Llam A&B”, “Art Construction 8 – Llam A&B”, “Art Construction 8 – Llam A&B” dhe ndërtesa “Administrative” të ndërtuara në kuadër të Bllokut urban “C-8” të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë, në rr. “Muharrem Fejza” dhe “Qazim Dobërdelani”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 23.01.2023, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET kërkuarit/ pronarëve Muharrem Sinani, Ekrem Biqku, Fatos Ferizaj, Shefqet Behramaj, Zijadin Biqkaj, Besnik Krasniqi, Afrim Mehmeti, Vigan Biqkaj, Labinot Biqkaj, Ardita Brajshori Biqkaj dhe Faton Biqkaj, me investitor “Art Construction LLC”, me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Faton Sinani nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-276527/22 dt. 28.12.2022, përdorimi i kompleksit me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm dhe ndërtesa administrative, përkatësisht ndërtesa “Art Construction 7 – Llam A&B”, me etazhitat B+P+6, “Art Construction 8 – Llam A&B”, me etazhitat 2B+P+6, “Art Construction 8 – Llam A&B”, me etazhitat 2B+P+6, dhe ndërtesa “Administrative”, me etazhitat 2B+S+P+6, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-148696/19 dt. 31.03.2020, në parcelen kadastrale nr. 1539-2, ZK Matiçan, në kuadër të Bllokut urban “C-8” të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugën “Muharrem Fejza” ku kanë dalje hyrjet me numrat: 218 dhe 220, dhe në rrugën “Qazim Dobërdelani” ku kanë dalje hyrjet me numrat: 10, 12, 14, 16, 18, 22, 24, 26, 28, 30, 32, 36, 38, 40, 42, 46, 48 dhe 52 në Prishtinë, dhe të njejtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njërive të saja në evidencat e regjistrimit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Kërkuarit/ pronaret Muharrem Sinani, Ekrem Biqku, Fatos Ferizaj, Shefqet Behramaj, Zijadin Biqkaj, Besnik Krasniqi, Afrim Mehmeti, Vigan Biqkaj, Labinot Biqkaj, Ardita Brajshori Biqkaj dhe Faton

Biqkaj, me investitor "Art Construction LLC", me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Faton Sinani nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-276527/22 dt. 28.12.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për kompleksin me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm dhe ndërtesës administrative, përkatësisht ndërtesa "Art Construction 7 – Llam A&B", me etazhitat B+P+6, "Art Construction 8 – Llam A&B", me etazhitat 2B+P+6, "Art Construction 8 – Llam A&B", me etazhitat 2B+P+6, dhe ndërtesa "Administrative", me etazhitat 2B+S+P+6, e ndërtuar në kuadër në kuadër të Bllokut urban "C-8" të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parceles kadastrale nr. 1539-2, ZK Matiçan, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-148696/19 dt. 31.03.2020, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-250515/22 dt. 22.12.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Inspektimi i sigurisë nga zjarri; Fotografitë gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Sevdut Bektashi/ Samire Hyseni; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Sami Idrizi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Astrit Salihu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Kushtrim Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Gazmend Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve të sigurisë nga zjarri, nga mbikqyrësi Naser Berisha; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga kompania gjeodeze e licensuar "Geo-Group" shpk me nr. të licensës 52;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certifikatë. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-276527/22 DT. 23.01.2023**

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu


U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi


Drejtori,
Arber Sadiki




